

## Termet e Referencës

### *Njoftim për Eksperti për tër monitorimin e Buxheteve te 8 Bashkive Vlore, Tirane, Korce,Librazhd, Elbasan, Lezhe, Shkoder dhe Durres*

|                   |  |
|-------------------|--|
| Organizata:       | Shoqata NdiHmoni Jetën<br>Fshati Prush, Njesia Administrative Vaqarr, Tirane<br>Tel: +355(044)803370<br>Web site: <a href="mailto:info@helphthelife.org.al">info@helphthelife.org.al</a> |
| Projekti:         | Te rrinjt me aftwsi tw kufizuar, advokojne pwr pwrfshirjen e tyre sociale.   |
| Koha e angazhimit | Nëntor 2019 –Dhjetor 2019  |

Shoqata “NdiHmoni Jetën”, është një organizatë kombëtare me një eksperiencë prej 20 vjetësh në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe ofrimit të Shërbimeve të aftësimin për jetën e fëmijëve dhe të rinjëve me aftësi të kufizuar në Qendër ditore, komunitet, dhe gjithëpërfshirje në sistemin arsimorë.

Shoqata NdiHmoni Jetën, është duke zbatuar Projektin “Te rrinjt me aftwsi tw kufizuar, advokojne pwr pwrfshirjen e tyre sociale.” i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga World Vision dhe SEEN.

Ky projekt synon fuqizimin i 200 të rinjtë me aftësi të kufizuara intelektuale për të siguruar përfshirjen e tyre në shoqëri, si dhe trajnimi i personelit të shërbimeve publike dhe prindërve për të mbështetur dhe inkurajuar vetë-përfaqësimin e të rinjve me aftësi të kufizuara intelektuale. Projekti do të zbatohet në disa nga bashkitë më thelbësore të vendit si, Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë, Vlorë, Lezhë, Librazhd dhe Prenjas.

***Në kuadër të implementimit të këtij projekti, Shoqata “NdiHmoni Jetën” kërkon të kontrakttoj një Ekspert për tër monitorimin e Buxheteve te 8 Bashkive Vlore, Tirane, Korce,Librazhd, Elbasan, Lezhe, Shkoder dhe Durres.***

### **Qëllimi i shërbimit:**

Monitorimi i Buxheteve te 8 Bashkive Vlore, Tirane, Korce,Librazhd, Elbasan, Lezhe, Shkoder dhe Durres dhe zhvillimi i nje trajnimi me teme Monitorimi i PBA per sherbimet Sociale ne Njesite Qendrore Vendore.

### **Detyrat që pritet të realizohen nga Eksperti:**

Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Koordinatorës të Projektit dhe ekspertit të fushës pranë Shoqatës, Ekspertit do të:

- Monitorimi dhe analizim i Buxheteve te 8 Bashkive Vlore, Tirane, Korce,Librazhd, Elbasan, Lezhe, Shkoder dhe Durres dhe zhvillimi i nje trajnimi me teme Monitorimi i PBA per sherbimet Sociale ne Njesite Qendrore Vendore per nje perjudhe 15 Ditore



This project is co-funded  
by the European Union



- Realizimi i nje trajnimi 1 ditor i stafeve te 8 Bashkive te perfshira ne projekt mbi Buxhetimin me pjesamrrje me qellim mobilizimin e komunitetit dhe institucioneve per mbeshtetjen e sherbimeve ndaj PAK dhe shpallja e gjetjeve te Analizes se buxheteve te Bashkive perkatese.
- Pregatitja e gjith materialeve te trajnimit.
- Pregatitja e Draft Axhendes
- Dorezimi i Studimit te Buxheteve te 8 bashkive ne Projekt me rekomandimet perkatese.

## **Përgjegjësitë e Ndihamoni Jetën**

- Të sigurojë Pjesmarrjen e stafeve te Bashkive te 8 Bashkive te perfshira ne projekt.

## **Kualifikime ose Njohuri te nevojshme:**

Eksperti duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Diplomë universitare në Financë ose Buxhetim;
- Minimumi i 5 vjet përvojë të vazhdueshme profesionale në fushën e buxhetimit;
- Pune te ngjashme e mëparshme në kryerjen e trajnimeve
- Njohuri dhe ndërgjegjësim për gjendjen e duhur të fëmijëve në Shqipëri dhe kornizën ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare;
- Rrjedhshmëri dhe aftësi në gjuhën angleze të shkruar dhe të folur, aftësi të shkëlqyera për shkrim raportesh dhe aftësi komunikimi;
- Aftësia për të punuar me mbikëqyrje minimale dhe nën presion.

**Vendi i konsulencës:** Tiranë

**Kohëzgjatja e konsulencës:** 10 Nëntor – 31 Dhjetor 2019

**Dite Konsulece ne Total:** 16 Dite

**Paraqitja e aplikimit:** Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

1. CV-në e tyre profesionale PDF ose MS Word

Aplikantët gjithashtu mund të dorëzojnë aplikimet e tyre në kopje fizike ose elektronike deri në ditën e mbylljes së thirrjes, 10 Nëntor 2019, ora 16:00, në adresat e mëposhtme:

1. Shoqata Ndihamoni Jetën, Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë
2. e-mail: [info@helphelife.org.al](mailto:info@helphelife.org.al)

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen.